



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:098270

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05467776

**C.nr.300/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: H.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe S.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovec – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.B.O nga Rahoveci, për shkak të kompensimi të shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 631.50 Euro, jashtë shqyrtimit, me datë **18.03.2024** merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësve: H.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe S.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, me të cilën kanë kërkuar që e paditura paditësve t’ua kompensoj shpërblimin jubilar, si në vijim:

- Paditësit H.I, shumën prej 315.75Euro, në vlerë të 75% të pagës bazë neto (421 Euro), për 22 vjet përvojë pune.
- Paditësit S.K, shumën prej 315.75Euro, në vlerë të 75% të pagës bazë neto (421 Euro), për 22 vjet përvojë pune, për të dy paditësit shumën e përgjithshme prej 631.50Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e parashtrimit të padisë (data 27.04.2023).

**II. OBLIGOHEN** paditësit H.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe S.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, që të paditurës Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale e Arsimit t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në emër të përgjigjes në padi në shumën prej 156.00Euro, të gjitha këto në afatin prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësit H.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe S.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tyre avokat D.M nga Prizreni, në këtë gjykatë me datën 27.04.2023 kanë parashtruar padi për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre Av. D.M në padi kanë theksuar se: janë të punësuar në pozitën mësimdhënës tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Faik Konica” në Celinë dhe

ende vazhdojnë të punojnë. Padiësi H.I ka 22 vite përvojë pune dhe padiësi S.K ka 22 vite përvojë pune. Të njëjtit konsiderojnë që atyre u takon e drejta në shpërblim jubilar dhe kërkesën e tillë e mbështetin në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017. Andaj, gjykatës i kanë propozuar që kërkesëpadië në padiësve: H.I nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit dhe S.K nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që padiësve t’ua paguajë shumat si në vijim: padiësit H.I, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, t’ia paguajë shumën prej 315.75 Euro, për 22 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75% të një page bazë dhe padiësit S.K, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, t’ia paguajë shumën prej 315.75 Euro, për 22 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75% të një page bazë, e për të dy padiësit shumën e përgjithshme prej 631.50 Euro, e të gjitha këto me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë (datë 27.04.2023), e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 177.00 Euro dhe atë: 156.00 euro në emër të përpilimit të padisë dhe 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj Av.B.O, në përgjigje në padi ka theksuar se e konteston padië dhe kërkesëpadië e padiësve në tërësi. Padiësit kanë ushtruar padi me datë 27.04.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e pagave jubilarë përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, në kohën kur nuk ka pasur Kontratë Kolektive të Arsimit në fuqi, për kompensimin e shpërblimit jubilar, në bazë të KKAK-së. Padiësi H.I, sipas listës së pagave nga Thesari i Shtetit, në kohën e parashtrimit të padisë të datës 27.04.2023 i ka arritur 24 vite përvojë dhe 20 vitet jubilarë i ka arritur në vitin 2017, ndërsa padië në ka parashtruar pas katër (4) vitesh dhe kërkesa është parashkruar në tërësi. Sipas listës së pagave të muajit dhjetor 2021, padiësi është mësimdhënës i shkollës fillore me pagën bazë 421.00 Euro, në grupin e pagave A-421/1. Padiësi S.K në kohën e parashtrimit të padisë me të me datë 27.04.2023, i ka arritur 24 vitet e përvojës në punë dhe në bazë të gjendjes faktike nuk i takon e drejta e kompensimit në emër të shpërblimit jubilar pasi që padiësi i ka arritur 20 vitet jubilarë në vitin 2017. Sipas listës së pagave të muajit dhjetor 2021, padiësi është mësimdhënës i shkollës fillore me pagën bazë 421.00 Euro, në grupin e pagave A-421/1. Gjykata mund të shqyrtojë një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse padiësit kanë shtetur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si punëdhënëse dhe atë konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212, neni par.1,2,3. Në bazë të nenit 90 par. 4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 është përcaktuar se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vite”*. Lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv të palës së paditur, i referohemi nenit 124 par.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrim të delegimit”*. Në bazë të Aktgjykimit të kësaj çështje, C.nr.666/2019 të datës 30.06.2021, respektivisht Aktgjykimit C.nr.677/2019 të datës 29.06.2021, padiësve tashmë u është njohur e drejta e kompensimit në emër të shpërblimit jubilar. Andaj, konsiderojmë se padia ndaj të paditurës është e palejuar, ndërsa gjykata me aktvendim duhet ta hedh poshtë në kuptim të nenit 391 par. 1 pika (dy) ngase çështja është gjë e gjykuar. Padia e padiësve nuk është bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjedhimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara me padi, padiësit nuk kanë mundur të argumentojnë themelësinë e kërkesëpadiës ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – DKA, andaj i propozoi gjykatës që ta refuzoj tërësisht kërkesëpadië e padiësve H.I dhe S.K për kompensimin e shpërblimit jubilar. Shpenzimet i ka kërkuar në shumë prej 156.00Euro sipas Tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësve është në tërësi e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënës tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët - SHFMU "Faik Konica" në fshatin Celinë, Komuna e Rahovecit. Kjo vërtetohet edhe nga Kontratat e punës.

Gjykata me shikimin në provat Lista e Buxhetit të Republikës së Kosovës Nr.10-90307-823-0912 të datës 31.12.2021, (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se paditësit janë anëtarë të SBASHK-ut dhe të njëjtit deri me datë 31.12.2021 kanë përvojë pune dhe realizojnë pagë neto si në vijim: paditësi H.I merr pagë bazë neto (467.65€uro), ka 22 vjet përvojë pune, paditësi S.K merr pagë bazë neto (467,65€uro), ka 22 vjet përvojë pune.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.5 e përcakton se "Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive".

Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe 01B-105 e datës 22.01.2021, në nenin 35 par.8 e përcakton se "punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit" nënpar. 8.1 "për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë" nënpar. 8.2 "për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë" nënpar. 8.3 "për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë" nënpar. 8.4 "për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë" dhe 8.5 "Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse".

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të lartëcekura është paraparë detyrimi i punëdhënësit, në rastin konkret të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë, për shkak se Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë.

E paditura në përgjigjen në padi pretendon se kërkesa është parashkruar dhe atë konform nenit 87 të Ligjit të Punës.

Ligji i Punës, me konkretisht neni 87 përcakton se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës",

Nga Listat e Pagave të Buxhetit të Republikës së Kosovës vërtetohet se paditësit deri me datë 31.12.2021 kishin përvojë pune nga 22 (njëzetë e dy) vite. Pretendimet e të autorizuarit të të paditurës se kërkesa është parashkruar qëndrojnë, për shkak se paditësit vitin jubilarë të 20 (njëzetë) e kanë arritur me 31.12.2019, pra koha kur kishin të drejtë të kërkojnë shpërblimin jubilar për vitin jubilarë të njëzetë. Nga data 31.12.2019 e deri me datë 31.12.2022 kishin të drejtë të kërkonin përmes rrugëve gjyqësore kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar si në kërkesëpadi, ndërsa padi kanë parashtruar pas kalimit të afatit 3 (tre) vjeçar, pra me datë 27.04.2023. Në këtë mënyrë gjykata vlerëson se e drejta e paditësve për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë është parashkruar, për faktin se të njëjtit këtë kërkesë e kanë parashtruar pas

afatit të paraparë ligjor, në kundërshtim me nenin 87 të Ligjit të Punës. Paditësit këtë të drejte kanë mundur që ta realizojnë deri me datë 31.12.2022, brenda afatit 3 vjeçar, nga momenti kur ka arritur viti jubilar (jubileu i njëzetë), ndërsa padinë e kanë parashtruar me datë 27.04.2023 dhe mbi këtë gjendje faktike e kanë humbur të drejtën që të kërkojnë shpërblim jubilar përmes rrugëve gjyqësore. Kërkesa e tillë është parashkruar sepse është paraqitur pas afatit ligjor.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoj se të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që pala paditëse t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore të paditurës, në kuptim të suksesit në kontest dhe atë: në emër të përpilimit të përgjigjes në padi shumë prej 156.00 Euro, sipas Tarifës së Avokatëve - OAK-së.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 399 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**C.nr.300/2023, datë 18.03.2024**

**G j y q t a r i,**

**Besmir JUNIKU**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizionit Civil.